



## Lajmërim për Aplikim në Raundin e 12-të, të Skemës Young Cell, Programi i BE-së për bursa post-diplomike 2018-2019

**Zyra e Bashkimit Evropian** në Kosovë dhe **Ministria e Integritimit Evropian**, lajmërojnë hapjen e konkursit për Raundin e 12-të të aplikimit në Skemën Young Cell, programi i BE-së për bursa post-diplomike për Kosovën, i cili aktualisht është duke u implementuar nga British Council. Aplikimi do të jetë i hapur nga dita **e hënë, 12 nëntor 2018** deri të **hënë, 03 dhjetor 2018**. Kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet mundësia të studiojnë për **Programe Master një vjeçare** në universitete të shteteve anëtare të BE-së. Programi i Bursave, **gjuha e punës e së cilit është vetëm gjuha angleze**, do të ofroj deri në 40 bursa të plota (numri real i bursave të ofruara mund të jetë më i vogël varësisht nga përshtatshmëria e kandidatëve dhe fondet në dispozicion). Kjo ftesë do të jetë e hapur për popullatën e përgjithshme dhe shërbyesit civil (deri në 10% të numrit të përgjithshëm të bursave të ofruara) dhe për studentët e diplomuar në fakultetet si: juridik, shkenca politike, ekonomik, menaxhment i biznesit, shkenca shoqërore, histori, shkenca humane, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, kriminologji dhe fusha të tjera akademike (siç është specifikuar në **Rregullat e Procedurës të disponueshme në web faqen zyrtare të programit në <http://ycskosovo.eu>**) në përputhje me sektorët në vijim:

- ◇ **1) Juridik – deri në 16 bursa në dispozicion**
- ◇ **2) Administratë Publike – deri në 8 bursa në dispozicion**
- ◇ **3) Ekonomik – deri në 8 bursa në dispozicion**
- ◇ **4) Kulturë dhe Shëndetsi – deri në 8 bursa në dispozicion**

Të drejtë konkurimi kanë:

- ◇ Qytetarët e Kosovës që posedojnë pasaportë të vlefshme të Kosovës apo letërnjoftimi të lëshuar nga Autoritetet Kosovare ose ata të cilët ofrojnë dëshmitë e lindjes dhe të vendbanimit në Kosovë (**vini re: çertifikata e lindjes dhe çertifikata e vendbanimit** të dyja kërkohen në rastet kur në asnjë mënyrë nuk mund të sigurohet letërnjoftimi).
- ◇ Të diplomuarit në njërin nga fushat e studimeve që iu përkasin sektoreve (ju lutemi referojuni Aneksit I të Rregullave të Procedurës në dispozicion në <http://ycskosovo.eu>). Studentët të cilët janë në përfundim të fakultetit poashtu mund të kenë të drejtë konkurimi nëse marrin diplomën jo më vonë se 31 korrik 2019.
- ◇ **Flasin rrjedhshëm gjuhën angleze** dhe shqipe apo serbe. Njohja e gjuhëve tjera të BE-së nuk do të konsiderohet përparësi.
- ◇ Janë të gatshëm të udhëtojnë dhe të lëvizin jashtë vendit nga muaji gusht 2019 deri tetor 2020 dhe të vijnë trajnime intenzive nga mesi i muajit shkurt 2019 dhe më tutje.
- ◇ Janë lindur më 1 Janar 1984 apo më vonë.

Bursat do të mbulojnë shpenzimet për deri në **40 bursistë**, si në vijim:

- ◇ Shpenzimet e aplikimit për programe master dhe shpenzimet e shkollimit
- ◇ Shpenzimet e jetesës për 12 muaj
- ◇ Shpenzimet e vizës & sigurimit shëndetësor
- ◇ Një biletë kthyesë
- ◇ Trajnimin e gjuhës angleze dhe testin e gjuhës angleze IELTS

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të zotohen të:

- ◇ Punojnë për Administratën Publike të Kosovës si praktikantë për së paku 1 muaj para nisjes (përveç shërbyesve civil të cilët veç janë të punësuar në Administratën Publike në Kosovë).
- ◇ Ndjekin Programin e Trajnimit të gjuhës në kuadër të YCS (ku është e nevojshme).
- ◇ Ndjekin dhe kryejnë studimet e zgjedhura post-diplomike.
- ◇ Përbushin obligimin e punësimit apo ripunësimit (nëse janë shërbyes civil) të pandërprerë tre vjeçar në Administratën Publike të Kosovës (përfshirë punësimin nëpër komuna dhe qeveri lokale, e preferueshme në vendbanimin e tyre), pas kthimit.

Përzgjedhja do të zhvillohet në tri faza dhe përfshinë:

- ◇ Para-përzgjedhja në kriteret administrative dhe ato të përzgjedhshmërisë.
- ◇ Testet me shkrim (njohja e gjuhës angleze, njohuri të përgjithshme për BE-në, vlerësimi verbal & numerik).
- ◇ Intervistë nga paneli i akademikëve evropianë. Përfaqësuesit e ZBE dhe të MIE do të marrin pjesë në panel si vëzhgues.

Femrat dhe përfaqësuesit e minoriteteve fuqimisht inkurajohen të aplikojnë. Formularët e aplikimit, Rregullat e Procedurës dhe të gjitha dokumentet tjera përcjellëse do të dërgohen përmes email-it tek të gjithë kandidatët e interesuar, pas regjistrimit në web faqen vijuese <https://ycskosovo.eu> deri më 3 dhjetor 2018. **Rregullat e Procedurës së bursave YCS Raundi XII, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe procedurave përkatëse**

**duhet të lexohen dhe të kuptohen** përpara dorëzimit të aplikacionit. Rregullat e Procedurës së YCS Raundit XII janë në dispozicion në <https://ycskosovo.eu>

Aplikuesit duhet të kompletojnë në **gjuhën angleze Formularin e Aplikimit YCS RXII, CV-në formatin Europass** dhe duhet të bashkangjesin në Aplikacion **Letrën Motivuese** të nënshkruar dhe me datë, duke shpjeguar se pse ata dëshirojnë të marrin pjesë në Skemë. Të gjithë Aplikantët në Aplikacionet e tyre po ashtu duhet të përfshijnë **kopjet e diplomave apo titujve të fituar dhe origjinalin (ose kopjet e çertifikuara të) transkripteve dhe kopjen e pasaportës së vlefshme/letërnjoftimin lëshuar nga autoritetet e Kosovës ose dëshmitë tjera të lindjes dhe të vendbanimit në Kosovë.**

Në rastin e **kandidatëve të cilët janë në përfundim të studimeve**, ata me aplikacion duhet të bashkangjesin **kopjen origjinale të përditësuar (ose të çertifikuar të) të transkriptit të notave me provime dhe një deklaratë të pregaditur nga vetë kandidati në lidhje me datën e pritur të diplomimit.**

Sigurohuni të shënoni në formularin e aplikimit YCS RXII dhe në CV –në e formatit Europass një **email adresë të VLEFSHME dhe numër të telefonit**. Të gjitha komunikimet me kandidatët do të bëhet vetëm përmes e-mailit.

Formati i CV-së Europass, formulari i aplikimit YCS RXII dhe Rregullat e Procedurës së YCS RXII do të dërgohen përmes email-it duke u regjistruar në webfaqen zyrtare të YCS dhe duke plotësuar formularin e aplikimit (nën faqen “ Aplikimet në Raundin XII”)

**Vini re: Aplikacionet e pakompletuara (mungesa e CV-së, e formularit të aplikimit dhe letrës së motivimit), aplikacionet të cilat nuk janë në gjuhën angleze dhe aplikacionet të cilat nuk përfshijnë CV-në e formatit Europass nuk do të shqyrtohen dhe do të përjashtohen automatikisht nga procedura e përzgjedhjes!**

**Afati i fundit për aplikim: E hënë, 3 dhjetor 2018, ora 17:00**

Aplikacionet e pranuar pas përfundimit të këtij afati nuk do të merren parasysh në çfarëdo rrethane.

Dorëzimi i aplikacionit, nga e hëna deri të premten nga ora 10:00 – 16:00, duhet të bëhet personalisht ose me postë të regjistruar/apo postë të shpejtë në pliko (zarfë) të mbyllur të adresuar te:

Young Cell Scheme - Aplikimi për Raundin XII,  
British Council, Rr. Perandori Justinian 106, Qyteza Pejton, 10000 Prishtinë (Kosovë)

**APLIKACIONET E DËRGUARA ME E-MAIL NUK JANË TË VLEFSHME DHE NUK DO TË MERREN PARASYSH**

*Ju lutemi mos bëni kërkesa të drejtëpërdrejta lidhur me aplikacionin tuaj.*

***Kandidatët që nuk kontaktohen deri me 10 Dhjetor 2018 nuk kanë arritur të kalojnë fazën e parë përzgjedhjes dhe që nuk kanë hyrë në listën e ngushtë për të marrë pjesë në provim me shkrim.***

Për më shumë informata mund të konsultoni <https://ycskosovo.eu> ose shkruani në [info@ycskosovo.eu](mailto:info@ycskosovo.eu)

*“Young Cell Scheme” (Raundi XI - XII) është Projekt i financuar nga BE, menaxhuar nga ZBE në Kosovë dhe implementuar nga British Council.*

